



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja k) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 2 paragrafi 3 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 1.11 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 10 mars 2021, mori këtë,

VENDIM PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT TË DONACIONIT NGA SHOQATA "HUMAN BRIDGE"

Neni 1

Për mbulimin e shpenzimeve / subvencionimin e transportit nga donacioni i Shoqatës "Human Bridge" me seli në Suedi, për pajisje dhe mallra për personat me nevoja të veçanta, si dhe pajisje tjera mjekësore, ndahen mjete buxhetore në shumë 5,000.00€.

Neni 2

Mjetet e cekura sipas nenit 1 të këtij vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, dhe të njëjtat barten në llogarinë bankare të Shoqatës "Human Bridge" në cilësinë e Donatorit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria e shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.01-400/03-0022494/21
Podujevë, 10 mars 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi

Arsyetim

Ky vendim është marrë duke marrë parasysh nevojat dhe kërkesat e shumta drejtuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për pajisje me mjete të ndryshme për personat me nevoja të veçanta me qëllim të ngritjes dhe përmirësimit të mirëqenies së kësaj kategorie të qytetarëve të Komunës së Podujevës, si dhe pajisje të ndryshe mjekësore, Komuna e Podujevës si përfituese e këtij donacioni nga donatori / sponsorizuesi Shoqata “Human Bridge” me seli në Suedi (e përfaqësuar nga z.Xhafer Balaj), dhe dakordimit për pranimin e donacionit me pajisje teknike, mobilje dhe mallra të ndryshme për personat me nevoja të veçanta si dhe pajisje tjera mjekësore me qëllim të përmirësimit dhe ofrimin e shërbimeve të natyrës së mirëqenies sociale dhe shëndetësore, si institucion i Komunës së Podujevës kemi shpreh gatishmërinë dhe përkushtimin tonë që të mbulohet përkatësisht të subvencionohet shpenzimi i transportit të donatorit, që krijohet me rastin e sjelljes së pajisjeve, mobileve dhe mallrave të ndryshme, të cekura si më lartë.